



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
AUTORITETI PËRGJEGJËS

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2022

Lënda: Dërgohet raporti vjetor 2022

INSPEKTORIATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

TIRANË

Me anë të kësaj shkrese, po Ju dërgojmë raportin vjetor për veprimtarinë e kryer nga Autoriteti Përgjegjës (AP) për parandalimin e konfliktit të interesave në zbatim të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9049, datë,10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë, i ndryshuar.

Në zbatim të pikës 3, nenit 42, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, i ndryshuar dhe pikës 7, të Udhëzimit nr.1, datë 27.06.2014 “Për krijimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e strukturave të autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave, në institucionet publike”, bashkëngjitur kësaj shkrese dërgohet raporti vjetor për veprimtarinë e kryer nga Autoriteti Përgjegjës (AP) për parandalimin e konfliktit të interesave. Në zbatim të nenit 3, shkronja gj, të ligjit nr.9049, datë,10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë, i ndryshuar, bashkëngjitur kësaj shkrese dërgohet lista e zyrtarëve që mbartin detyrimin për deklarim periodik të interesave private në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Bazuar në strukturën organike të miratuar me Urdhrin nr. 146, datë 28.09.2018 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, i ndryshuar, pozicioni i Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Arsimore është pozicion vakant, në listën e funksioneve që mbartin detyrim për deklarim të interesave private periodike. Bashkëngjitur kësaj shkrese dërgohet:

- lista në bazë të strukturës organike sipas funksioneve të subjekteve që mbartin detyrim për deklarim të interesave private,
- lista emërore e zyrtarëve që mbartin detyrim për deklarim të interesave private,
- regjistri vjetor i evidentimit dhe zgjidhjes së rasteve të konfliktit të interesave.

Për çdo informacion jeni të lutur të kontaktoni me autoritetin përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave dhe z. Agim Alia si person kontakti, në adresën: QSHA, Bulevardi Zhan D'Ark, nr.23, Tiranë, Tel: + 355 4 2419257, e-mail Agim_Alia@qsha.gov.al

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

Me respekt,

Aurora BALLIU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Raporti vjetor për veprimtarinë e kryer nga Autoriteti Përgjegjës (AP) për parandalimin e konfliktit të interesave

1. Kuadri ligjor:

Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) është institucion publik, buxhetor i krijuar me ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin nr. 8, datë 13.03.2017 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, i ndryshuar, në varësi të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, që ka për mision ofrimin e shërbimeve dhe sigurimin e aksesit publik në fushën e arsimit të lartë dhe arsimit parauniversitar.

Ajo ushtron funksion teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave të vlerësimit, të aplikimit dhe të organizimit të provimeve të maturës shtetërore e të provimeve të shtetit. Me Urdhrin nr. 146, datë 28.09.2018 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore” i ndryshuar, është miratuar struktura dhe organika e QSHA-së.

QSHA në ushtrimin e veprimtarisë së saj mbështetet në legjislacionin në fuqi, në ligjet për arsimin parauniversitar dhe atë të lartë dhe njëkohësisht në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këto fusha si dhe statutin dhe rregulloren e brendshme të miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, rregulloren e brendshme për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale dhe rregulloren e brendshme për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

QSHA me shkresën nr.5497 prot., datë 18.11.2019, drejtuar ILDKPKI, ka dërguar Rregulloren “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, e cila shfuqizon e rregulloren e mëparshme.

QSHA në veprimtarinë e saj zbaton ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, i ndryshuar dhe ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 ”Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

2. Ngritja dhe funksionimi i Autoritetit Përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave:

QSHA (ish AKP) bazuar në nenin 41, pika 2 e ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, i ndryshuar, me urdhër nga titullari i institucionit nr.17/1, datë 25.04.2014, “Për ngritjen e AP për parandalimin e KI”, ka ngritur Autoritetin Përgjegjës (AP) për parandalimin e konfliktit të interesave si strukturë e veçantë e cila do të mbajë në vijimësi marrëdhëniet dhe kontaktet me ILDKPKI.

QSHA bazuar në nenin 41, pika 2 e ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, i ndryshuar, me urdhër nga titullari i institucionit nr.134, datë 23.12.2021, “Për ngritjen e AP për parandalimin e KI”, ka ngritur Autoritetin Përgjegjës (AP) për parandalimin e konfliktit të interesave si strukturë e veçantë e cila do të mbajë në vijimësi marrëdhëniet dhe kontaktet me ILDKPKI. Ky Urdhër shfuqizon urdhrin e mëparshëm nr.43, datë 11.12.2018. (Bashkëlidhur këtij raporti gjeni një kopje të urdhrin).

QSHA bazuar në nenin 41, pika 2 e ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, i ndryshuar, me urdhër nga titullari i institucionit nr. 220, datë 30.12.2022, “Për ngritjen e AP për parandalimin e KI”, ka ngritur Autoritetin Përgjegjës (AP) për parandalimin e konfliktit të interesave si strukturë e veçantë e cila do të mbajë në vijimësi marrëdhëniet dhe kontaktet me ILDKPKI. Ky Urdhër shfuqizon urdhrin e mëparshëm nr. 134, datë 23.12.2021. (Bashkëlidhur këtij raporti gjeni një kopje të urdhrin). Autoriteti Përgjegjës përbëhet nga tre veta dhe drejtues i njësisë Autoritet Përgjegjës është caktuar Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Dy anëtarët e tjerë janë Drejtori i Drejtorisë së Vlerësimit dhe Drejtori i Drejtorisë së Provimeve të Shtetit.

QSHA, me urdhër nr.135, datë 23.12.2021, ka ngritur autoritetin përgjegjës për monitorimin e zbatimit dhe respektimit të rregullave të etikës (Bashkëlidhur gjeni një kopje të urdhrin). QSHA, me urdhër nr. 219, datë 30.12.2022, ka ngritur autoritetin përgjegjës për monitorimin e zbatimit dhe respektimit të rregullave të etikës. Ky Urdhër shfuqizon urdhrin e mëparshëm nr. 135, datë 23.12.2021. (Bashkëlidhur këtij raporti gjeni një kopje të urdhrin). Autoriteti Përgjegjës përbëhet nga tre veta dhe drejtues i njësisë Autoritet Përgjegjës është caktuar Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Dy anëtarët e tjerë janë Drejtori i Drejtorisë së Vlerësimit dhe Drejtori i Drejtorisë së Provimeve të Shtetit.

3. Parandalimi, kontrolli dhe zgjidhja e gjendjeve të konfliktit të interesave:

Autoriteti Përgjegjës ka marrë të gjitha masat e nevojshme për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave:

a) Për procesin e deklarimit të interesave private:

- i. Është bërë njoftimi, dhënia e konsulencës dhe dorëzimi i deklaratave të interesave private si dhe respektimi i afateve ligjore nga ana e tyre.
- ii. Në zbatim të nenit 3, shkronja gj, të ligjit nr.9049, datë,10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë, i ndryshuar, në listën e zyrtarëve që mbartin detyrimin për deklarim periodik të interesave private në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive janë: znj. Aurora Balliu, në pozicionin Drejtore e Përgjithshme, kategoria II-a, z. Agim Alia në pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Vlerësimit, kategoria II-b dhe z. Seldi Beta në pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Provimeve të Shtetit, kategoria II-b. Pozicioni i Drejtorit në Drejtorinë e Shërbimeve Arsimore, kategoria II-b, është vakant.
- iii. Me vërtetimin e lëshuar nga ILDKPKI nr. extra prot., datë 14.10.2022, “Dërgohen deklaratat e interesave private periodikë vjetore”, e regjistruar në QSHA me nr.4629/2 prot., datë 14.10.2022, është dorëzuar deklarata e interesave private periodike vjetore, për znj. Aurora Balliu, me funksion Drejtore e Përgjithshme e Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Me vërtetimin e lëshuar nga ILDKPKI nr. extra prot., datë 07.04.2022, “Dërgohen deklaratat e interesave private periodikë vjetore”, e regjistruar në QSHA me nr. 1746/1 prot., datë 07.04.2022, është dorëzuar deklarata e interesave private periodike vjetore, për z. Agim Alia, me funksion Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit, në Qendrën e Shërbimeve Arsimore. Me vërtetimin e lëshuar nga ILDKPKI nr. extra prot., datë 05.04.2022, “Dërgohen deklaratat e interesave private para fillimit të detyrës”, e regjistruar në QSHA me nr. 1746 prot., datë 05.04.2022, është dorëzuar deklarata e interesave private para fillimit të detyrës, për z. Seldi Beta, me funksion Drejtor i Drejtorisë së Provimeve të Shtetit, në Qendrën e Shërbimeve Arsimore.
- iv. Me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të QSHA nr. 25 datë 24.02.2022, “Për përfundimin e marrëdhënieve juridike të punës”, znj. Valbona Sheshi, ka përfunduar marrëdhëniet juridike të punës në funksionin e Drejtorit të Drejtorisë së Provimeve të Shtetit, në Qendrën e Shërbimeve Arsimore. Me vërtetimin e lëshuar nga ILDKPKI nr. extra prot., datë 23.02.2022, “Dërgohen deklaratat e interesave private periodikë vjetore”, e regjistruar në QSHA me nr. 1123 prot., datë 24.02.2022, është dorëzuar deklarata e interesave private periodike vjetore, për znj. Valbona Sheshi, me funksion Drejtor i Drejtorisë së Provimeve të Shtetit, në Qendrën e Shërbimeve Arsimore. Deklarata e interesave private, pas largimit nga detyra do të dorëzohet në ILDKPKI, nga vetë subjekti i deklarimit. Nga verifikimet në sistemin elektronik për deklarimin e pasurive dhe konfliktit të interesave (EACIDIS), rezulton se është dorëzuar.

- v. Me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të QSHA nr. 11 datë 31.01.2022, “Për zgjidhjen e menjëhershme të justifikuar të marrëdhënieve juridike të punës”, z. Dorjan Doka, ka përfunduar marrëdhëniet juridike të punës në funksionin e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Arsimore, në Qendrën e Shërbimeve Arsimore. Deklarata e interesave private pas largimit nga detyra do të dorëzohet në ILDKPKI, nga vetë subjekti i deklarimit. Nga verifikimet në sistemin elektronik për deklarimin e pasurive dhe konfliktit të interesave (EACIDIS), rezulton se është dorëzuar.
- vi. Nuk është evidentuar asnjë rast i mosrespektimit të afateve ligjore për dorëzimin e deklaratave të interesave private.
- vii. Nuk është evidentuar asnjë rast i marrjes së masave disiplinore për shkelje të konstatuara të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar dhe ligjit nr.9367, datë 07.04.2005.

b) Për identifikimin dhe regjistrimin e rasteve të konfliktit të interesave:

- i. Në zbatim të nenit 10, pika 2 është lëshuar autorizimi nga ana e të gjithë punonjësve në favor të institucionit publik ku ushtron funksionet, nëpërmjet të cilit ata e autorizojnë institucionin QSHA që të kryejë kontroll dhe të sigurojë të dhëna vetjake për zyrtarin kudo ku ato janë regjistruar.
- ii. Gjatë vitit 2022 janë evidentuar dhe regjistruar 7 (shtatë) raste të konfliktit të interesave, 1 (një) rast që lidhet me Maturën Shtetërore, 2 (dy) raste që lidhet me Olimpiadat Kombëtare, 1 (një) rast që lidhet me VANAF, 1 (një) rast që lidhet me PKAB, si dhe 2 (dy) raste që lidhen me mësimdhënien në IAL.
- iii. Lidhur me rastin e verifikuar dhe të kontrolluar për konflikt interesi, informojmë si vijon:
Lidhur me Maturën Shtetërore 1 (një) punonjës i QSHA-së kanë bërë vetë deklaram, duke i dërguar deklaratën e konfliktit të interesave Drejtorit të Përgjithshëm, i cili do të vendosë rast pas rasti lidhur me rastet kur nuk mund të përfshihen në procesin e MSH. Lidhur me trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave informojmë si vijon:
Me shkresën nr.1757 prot, datë 06.04.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të QSHA-së, ka informuar z. Kridens Laçi se nuk mund të përfshihet në asnjë nga fazat e MSH, me qëllim shmangin e çdo lloj konflikt interesi.
- iv. Lidhur me 2 (dy) rastet e verifikuar dhe të kontrolluar për konflikt interesi, që lidhen me olimpiadat kombëtare, informojmë si vijon:
Z. Agim Alia, Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit, ka bërë vetëdeklarim se ka nipin kandidat që do të marrë pjesë në olimpiadën 2022, lënda matematikë. Me shkresën nr. 58/1 prot, datë 06.01.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të QSHA-së, ka informuar z. Agim Alia se nuk mund të përfshihet në asnjë nga fazat e olimpiadave, për lëndën e matematikës, me qëllim shmangin e çdo lloj konflikt interesi.
Z. Agim Alia, Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit, ka bërë vetëdeklarim se ka nipin kandidat që do të marrë pjesë në olimpiadën 2023. Me shkresën nr. 5530/1 prot, datë 01.12.2022, të

Drejtorit të Përgjithshëm të QSHA-së, ka informuar z. Agim Alia se nuk mund të përfshihet në asnjë nga fazat e olimpiadave, me qëllim shmangin e çdo lloj konflikt interesi.

- v. Lidhur me 1 (një) rast të verifikuar dhe të kontrolluar për konflikt interesi, që lidhen me VANAF, informojmë si vijon:

Z. Agim Alia, Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit, ka bërë vetëdeklarim se ka vazhën nxënëse që do të marrë pjesë në VANAF 2022. Me shkresën nr.1604/1 prot, datë 25.03.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të QSHA-së është informuar se nuk mund të përfshihet në asnjë nga fazat e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor, klasa e pestë, me qëllim shmangien e çdo lloj konflikt interesi.

- vi. Lidhur me 1 (një) rast të verifikuar dhe të kontrolluar për konflikt interesi, që lidhen me PKAB, informojmë si vijon:

Z. Agim Alia, Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit, ka bërë vetëdeklarim se ka nipin nxënës që do të marrë pjesë në PKAB 2022. Me shkresën nr.1506/1 prot, datë 18.03.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të QSHA-së është informuar se nuk mund të përfshihet në asnjë nga fazat e provimeve kombëtare të arsimit bazë, klasa e nëntë, me qëllim shmangien e çdo lloj konflikt interesi.

- vii. Lidhur me 2 (dy) raste të verifikuar dhe të kontrolluar për konflikt interesi, që lidhen me përfshirjen në mësimdhënie në IAL, informojmë si vijon:

Deklaratë e interesave zyrtare në ushtrimin e funksioneve publike nr.4184/2 prot, datë 15.09.2022. Memo e AP, drejtuar DP, nr.4184/3 prot., datë 27.09.2022. Shkresë e DP, drejtuar ILDKPKI “Përcillet për trajtim nr.4184/4 prot., datë 28.09.2022. Shkresë e ILDKPKI, drejtuar QSHA “Kthim përgjigje”, nr.2984/1 prot., datë 14.10.2022, e regjistruar në QSHA me nr.4184/5 prot., datë 24.10.2022. Shkresë e AP, drejtuar DP, nr.5213/1 prot., datë 11.11.2022, “Dërgohet raporti lidhur mbi shkresën e ILDKPKI”. Shkresë e DP, drejtuar z. Vangjeli nr.5213/2 prot., datë 18.11.2022, ku informohet që me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike duhet të veprojnë sipas rekomandimeve të AP. Deklaratë mbi konfliktin e interesave e z. Olsi Vangjeli nr. 5843 prot., datë 20.12.2022. Shkresë drejtuar ILDKPKI nr. 4184/6 prot., datë 20.12.2022, “Kthim përgjigje”.

Deklaratë e interesave zyrtare në ushtrimin e funksioneve publike nr.4184/2 prot, datë 15.09.2022. Memo e AP, drejtuar DP, nr.4184/3 prot., datë 27.09.2022. Shkresë e DP, drejtuar ILDKPKI “Përcillet për trajtim nr.4184/4 prot., datë 28.09.2022. Shkresë e ILDKPKI, drejtuar QSHA “Kthim përgjigje”, nr.2984/1 prot., datë 14.10.2022, e regjistruar në QSHA me nr.4184/5 prot., datë 24.10.2022. Shkresë e AP, drejtuar DP, nr.5213/1 prot., datë 11.11.2022, “Dërgohet raporti lidhur mbi shkresën e ILDKPKI”. Shkresë e DP, drejtuar znj. Begaj nr.5213/3 prot., datë 18.11.2022, ku informohet që me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike duhet të veprojnë sipas rekomandimeve të AP. Deklaratë mbi konfliktin e interesave e znj. Elida Begaj nr. 5843/1 prot., datë 20.12.2022. Shkresë drejtuar ILDKPKI nr. 4184/6 prot., datë 20.12.2022, “Kthim përgjigje”.

- viii. Vëmë në dijeni se nuk ka patur raste konfliktit të interesave të pazgjidhura të raportuara në ILDKPKI, gjykatë, prokurori apo institucione të tjera.

5. Roli këshillues dhe trajnues i Autoritetit Përgjegjës:

Në kryerjen e veprimtarisë sonë jemi përpjekur që të ndihmojmë punonjësit dhe eprorët për çështjet dhe momentet kur ata duhet të tregohen të kujdesshëm për parandalimin e konfliktit të interesave. Të gjithë punonjësit i kemi informuar dhe këshilluar lidhur me ligjin nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar dhe ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore. Gjithashtu me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të QSHA-së, nr.61, datë 18.11.2019 është miratuar rregullorja e brendshme për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike. Rregullorja e brendshme për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale dhe rregullorja e brendshme për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit në internet.

Duke shprehur konsideratën tonë më të lartë,

Datë 30.12.2022

AUTORITETI PËRGJEGJËS

- a. z. Eduard Meçaj, me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
- b. z. Agim Alia, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit.
- c. z. Seldi Beta, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Provimeve të Shtetit.